

V E N D I M
Nr.119, datë 27.2.1995

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.286, DATË
30.5.1994 “PËR ADMINISTRIMIN E SENDEVE QË KALOJNË NË DOBI TË SHITETIT NGA
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE”**

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.286, datë 30.5.1994, në pikën 2, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

“Sendet e përcaktuara në pikën 1, për të cilat vendimet për kundërvajtje administrative nuk kanë marrë formë të prerë, administrohen nga organet administrative që kanë vendosur kalimin e tyre në dobi të shtetit, me përjashtim të karburanteve, automjeteve, mjeteve të vogla të lundrimit, si dhe mallrave të ndryshme që janë tepër vëllimore dhe në sasi të mëdha, të cilat të magazinohen në mjediset e Rezervës së Shtetit, të dokumentuara si mall në ruajtje sipas dispozitave në fuqi”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi